



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI DHE KRYENEGOCIATOR

RAPORT PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2024 TË REALIZUAR NGA MINISTRI I SHTETIT DHE KRYENEGOCIATOR

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë vitit 2024, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ka përmbushur plotësisht detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Konkretisht gjatë vitit 2024 janë konsultuar projekvendimet e mëposhtme:

- 1.Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 16, datë 11.1.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026”;
- 2.Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 621, datë 10.10.2024, Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.

Vendimet e Këshillit të Ministrave u konsultuan në regjistrin elektronik të konsultimeve publike, si një parakusht ligjor për procesin e konsultimit publik, si dhe nëpërmjet metodave të tjera të konsultimit publik si tryeza diskutimi.

Pjesëmarrja e aktorëve në procesin e konsultimit konsiderohet e lartë dhe reagimet e tyre gjithashtu. Për Agjendën Kombëtare të Reformave u dërgua një numër i lartë komentesh dhe rekomandimesh nga grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare gjithashtu.

Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik dhe në proceset e politikëbërjes mbetet një sfidë për t’u adresuar në mënyrë vijuese.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Gjatë vitit 2024, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ka iniciuar miratimin e 5 (pesë) projektvendimeve të Këshillit të Ministrave.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ka miratuar 2 (dy) akte gjatë vitit 2024, të cilat kualifikohen për konsultim publik sipas parashikimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

MiSHKN ka realizuar procesin e konsultimit publik për të dy këto projektvendime.

Aktet e tjera të miratuara, nuk janë objekt i konsultimit ose ligji përcakton përjashtimin e tyre nga procesi sipas kufizimeve të nenit 4.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Nuk është e aplikueshme. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator nuk ka propozuar asnjë projektligj gjatë vitit 2024.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator nuk ka pasur akte të parashikuara në programin analitik për vitin 2024, sikurse miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.790/2023 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”.

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator nuk ka pasur projektakte të parashikuara për miratim në kuadër të dokumenteve të tjera strategjike.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Aktet e konsultuara janë 2 projektvendime të Këshillit të Ministrave:

1.Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 16, datë 11.1.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026”;

2.Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 621, datë 10.10.2024, Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ka propozuar gjatë vitit 2024 vetëm projektvendime të Këshillit të Ministrave.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar më një vit me parë është rritur numri i akteve të konsultuara dhe pjesëmarrja e aktorëve në proces. MSHKN ka përmbushur plotësisht detyrimet për procesin, njësoj si vitet e kaluara.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metoda më e përdorur është Regjistri Elektronik i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, në databazën e të cilit aktorët e interesit të identifikuar të fushës së integritetit janë të regjistruar dhe u është dërguar njoftim automatik për pjesëmarrje në proces. Kjo metodë konsultimi është përdorur për konsultimin e PKIE 2024 – 2026 dhe AKR 2024 -2027.

Për konsultimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, në datën 26 korrik 2024 u organizua dhe një takim nga Sekretariati BE, me praninë e organizatave të mësipërme dhe përfaqësues nga ministrinë e linjës, për të diskutuar mbi komentet e paraqitura.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Konsultimi në regjistrin elektronik gjeneroi **2 komente** për PKIE 2024 – 2026.

Ndërsa konsultimi i zhvilluar për AKR 2025 - 2027, në regjistrin elektronik gjeneroi **72 komente** nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI); Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women); Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE), Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCIDEV), Qendra Jonathan dhe Partners Albania. Këto komente u diskutuan gjerësisht edhe në takimin e dedikuar, të organizuar nga Sekretariati BE, të zhvilluar me praninë e këtyre organizatave dhe me përfaqësues nga ministrinë e linjës.

*2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit?
Nëse po, në sa raste?*

Institucioni nuk zhvilloi konsultime në fazën e hershme të hartimit të projektaktit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi nëpërmjet regjistrit elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik, për të dy aktet, zgjati për 20 ditë pune, sikurse kërkuar nga Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Kohëzgjatja më e gjatë ishte 44 ditë kalendarike.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik ishte 36 dite kalendarike.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Ka pasur rritje të kohëzgjatjes së konsultimeve, e cila përkon dhe me rritje të numrit të akteve për konsultim publik.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në hartimin e projektvendimeve të miratuara nuk morën pjesë aktorë të jashtëm jo-qeveritarë.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Nuk ka pasur anëtarë të jashtëm jo-qeveritarë pjesëmarrës në hartimin e projektvendimeve.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Në konsultimet e hapura në regjistrin elektronik numri i vizitorëve për të dy vendimet ishte 3739.

Në tryezat konsultative për VKM miratuese të dokumentit të AKR 2024-2027 morën pjesë 6 organizata ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, të cilat kishin paraqitur komentet përkatëse përmes regjistrit të konsultimit publik.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

U paraqitën 72 komente nga dy organizata ndërkombëtare dhe 4 organizata të shoqërisë civile, si vijon: Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI); Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women); Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE), Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCIDEV), Qendra Jonathan dhe Partners Albania.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Po, ka pasur përmirësime të situatës krahasuar me një vit më parë. Është rritur numri i aktorëve pjesmarrës si dhe shikueshmëria dhe reagueshmëria nga vizitorët në RENJKP.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në procesin e konsultimit me publikun, u morën gjithsej 74 komente dhe rekomandime, 2 për PKIE 2024 – 2026 dhe 72 për AKR 2025 – 2027.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nga 74 komente, 39 prej tyre u pranuan dhe 35 prej tyre u refuzuan.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Procesi i konsultimit publik ka ardhur duke u përmirësuar, por për natyrën specifike të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian nuk vërejmë ndryshim të tendencës krahasuar me vitet e tjera. Sa e përket AKR procesi ka qënë cilësor dhe reagimet e mbledhura kontribuan në përmirësimin e cilësisë së aktit.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Nuk është e aplikueshme. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator nuk ka propozuar asnjë projektligj gjatë vitit 2024.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator publikoi 2 raporte konsultimi, sikurse kërkuar nga ligji në fuqi.

1. [Programi Kombëtar për Aderimin në BE 2024-2030 dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026](#)
2. [Dokumenti i Politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027”.](#)

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk është e aplikueshme.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator për vitin 2024, sikurse sipërpërmendur ka konsultuar gjithsej 2 (dy) akte. Bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, sugjerojmë vlerësimin maksimal 8 (tetë) për procesin e kryer të konsultimit publik për vitin 2024.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfida kryesore në lidhje me konsultimin e projektakteve të lidhura me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian mbetet përfshirja sa më e madhe e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e konsultimit publik, duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe natyrën teknike të projektakteve.

Në aspektin institucional nuk ka vështirësi. Procesi i konsultimit publik i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian kryhet çdo vit dhe periudha e konsultimit është e parashikuar në programin e punës për hartimin e këtij dokumenti.